Breaking News:

Komunikata

29/01/2026

Raporti I Ngjarjeve, 29 Janar 2026

Drejtoria Vendore e Policisë Korçë

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Pogradec referuan materialet në Prokurori, ku filloi procedimi penal për shtetasin A. P., 54 vjeç, banues në fshatin Radokaj i Sipërm, Pogradec, për veprat penale "Prishja e qetësisë publike" dhe "Shkelja e karantinës së bimëve dhe kafshëve". Ky shtetas, dje, në fshatin ku banon, ka gjuajtur shpendë, me armë gjahu të cilën e posedonte me leje. Arma e gjahut u sekuestrua në cilësinë e provës materiale.

Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, për veprime të mëtejshme.

Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë/Gjatë 48-orëve të fundit.

Specialistët për Hetimin e Narkotikëve:
-arrestuan shtetasin L. Ç., 36 vjeç, pasi gjatë kontrollit fizik, shërbimet e Forcës së Posaçme "Shqiponja" i gjetën një sasi lëndë të dyshuar narkotike Kokainë, e cila u sekuestrua me cilësinë e provës materiale;
-në bashkëpunim me shërbimet e Komisariatit të Policisë Nr. 6, ekzekutuan vendimin për ndalimin e shtetasit B. H., 40 vjeç që është dënuar me 4 vjet e 8 muaj burgim, për veprën penale "Prodhimi dhe shitja e narkotikëve". Nga dënimi, 40-vjeçarit i kanë mbetur për të vuajtur rreth 2 vjet e 2 muaj burgim;
-arrestuan shtetasin I. M., 65 vjeç, pasi gjatë kontrolleve, shërbimet e Komisariatit të Policisë Nr. 3 i gjetën një sasi lëndë të dyshuar narkotike Kokainë, e cila u sekuestrua me cilësinë e provës materiale.

Specialistët për Hetimin e Krimeve Kibernetike referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi penal për shtetasit:
-P. P., pasi dyshohet se ka përndjekur nëpërmjet llogarive false në rrjete sociale, një shtetase;
-B. B., pasi dyshohet se ka shpërndarë video të një shtetasteje.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Nr. 1:
-arrestuan shtetasin A. T, 48 vjeç, pasi dyshohet se për motive të dobëta ka ushtruar dhunë ndaj xhaxhait të tij;
-referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi penal për shtetasin I. Z, pasi gjatë kontrollit të një objekti në pronësi e tij janë gjetur e sekuestruar një masë municioni;
-referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi penal për shtetasin E. M., si dhe punohet për kapjen e shtetasit E. M, pasi dyshohet se për motive të dobëta kanë goditur me grushte shtetasin A. B;
-shpallën në kërkim shtetasin A. C., pasi dyshohet se ka ushtruar dhunë ndaj të dashurës së tij. Punohet për kapjen e këtij shtetasi.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Nr. 2:
-në bashkëpunim me shërbimet e Komisariatit të Policisë Nr. 3, arrestuan shtetasen A. K., 30 vjeçe, pasi u kap duke drejtuar automjet, pa leje, ndërkohë që ishte me masë sigurie "Arrest në shtëpi". Gjatë kontrollit në autorrojet u gjetën 2 armë të fshehta që u sekuestruan me cilësinë e provës materiale;
-arrestuan shtetasin K. D., 28 vjeç, pasi dyshohet se ka ngacmuar seksualisht një 30-vjeçare;
-referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi penal për shtetasit B. M. dhe V. Xh., pasi dyshohet se për shkak të mosmarrëvesjeve për një shumë parash, janë konfliktuar fizikisht, me njëri-tjetrin;
-referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi penal për shtetasin K. P., pasi dyshohet se për motive të dobëta, ka kanosur shtetasin L. Sh.;
-referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi penal për shtetasit G. H. dhe E. M., pasi dyshohet se kanë kanosur shtetasin D. K;
-referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi penal për shtetasin D. M, pasi dyshohet se ka kanosur shtetasen M. Sh;
-referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi penal për shtetasit B. T., Th. P. dhe A. H., pasi dyshohet se kanë hedhur merte (materiale ndërtimi), në rrugën "Andrea Kushi", dhe si pasojë është ndotur ambienti;
-shpallën në kërkim shtetasin Xh. Ll., pasi dyshohet se ka ushtruar dhunë ndaj të dashurës së tij. Punohet për kapjen e këtij shtetasi.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Nr. 3:
-ekzekutuan vendimin për ndalimin e shtetasit L. K., 34 vjeç, të dënuar me 1 muaj burgim, për veprën penale "Dhuna në familjë";
-referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi penal për shtetasit G. Z. dhe B. Z., pasi dyshohet se për motive të dobëta, kanë goditur me grushte, shtetasit A. D. dhe B. D;
-referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi penal për shtetasin B. K, pasi dyshohet se ka prishur qetësinë brenda një institucioni;
-referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi penal për shtetasin A. M, pasi dyshohet se për motive të dobëta ka goditur me shpullë shtetasin O. B;
-referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi penal për shtetasin R. A, pasi dyshohet se ka kanosur në anë të celularit shtetasin F. G;
-referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi penal për shtetasen S. Z, pasi nuk i është bindur urdhërit të punonjëses së Policisë;
-referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi penal për shtetasit J. Ç, A. H dhe B. D, pasi në lokalin në administrim të tyre, kanë prishur qetësinë publike, duke gjeneruar muzikë me volum të lartë;
-shpallën në kërkim shtetasin R. D., pasi dyshohet se ka ushtruar dhunë ndaj të fejuarës së tij. Punohet për kapjen e këtij shtetasi.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Nr. 4:
-arrestuan shtetasin S. B, 61 vjeç, pasi dyshohet se për motive pronësie ka goditur vëllain e tij i cili po merr ndihmë mjekësore në spital;
-arrestuan shtetasin D. P, 45 vjeç, pasi dyshohet se ka ushtruar dhunë ndaj bashkëshortes së tij;
-referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi penal për shtetasin E. S., pasi dyshohet se ka ushtruar dhunë ndaj vëllait të tij;
-referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi penal për shtetasin A. K, pasi dyshohet se për motive të dobëta ka goditur me grushte shtetasin B. Li;
-shpallën në kërkim shtetasin A. H., pasi dyshohet se ka përndjekur 2 shtetasa. Punohet për kapjen e tij;
-shpallën në kërkim shtetasin M. K., pasi dyshohet se nëpërmjet mashtrimit, ka marrë një automjet, të cilin e ka braktisur në rrugën "Marie Krajë", të dëmtuar. Punohet për kapjen e shtetasit M. K. dhe për sqarimin e rrethanave të rastit;
-shpallën në kërkim shtetasin S. T., pasi dyshohet se ka thyer traun e një garazhdi. Punohet për kapjen e tij dhe për sqarimin e rrethanave të rastit.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Nr. 5:
-referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi penal për 2 të mitur pasi për motive të dobëta janë konfliktuar me njëri-tjetrin;
-shpallën në kërkim shtetasin B. K., pasi dyshohet për motive të dobëta, ka goditur shtetasin A. V. Punohet për kapjen e shtetasit B. K.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Nr. 6:
-arrestuan shtetasin A. L, 30 vjeç, pasi dyshohet se ka ushtruar dhunë ndaj nënës së tij. Gjatë kontrollit fizik, u gjet një sasi lëndë e dyshuar narkotike kokainë;
-referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi penal për shtetasin I. K, pasi dyshohet se ka kanosur shtetasin K. H;
-referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi penal për një të mitur pasi dyshohet se ka goditur me grushtë, një të mitur;
-shpallën në kërkim shtetasin F. T., pasi dyshohet se në Vzberisht, në bashkëpunim me një shtetas tjetër, ende të paidentifikuar, kanë goditur me grushte, shtetasin E. D. (rast i publikuar në rrjete sociale). Punohet për kapjen e shtetasit F. T., si dhe për identifikimin dhe kapjen e bashkëpunëtorit të tij.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Nr. 7 referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi penal për shtetasit:
-E. H, pasi dyshohet se për motive të dobëta, ka goditur me grushtë, një shtetas;
-R. C., pasi dyshohet se ka goditur një shtetas.

Specialistët e qarkullimit rrugor arrestuan shtetasit:
-F. Z., 37 vjeç dhe E. K., 45 vjeç, pasi u kapën duke drejtuar automjete, në gjendje të dehur;
-A. C., 23 vjeç, pasi u kap duke drejtuar automjet, pa leje drejtimi.

-me datë 27.01.2026, kallëzoi shtetasi V. G., se i kishin vjedhur motorsipërin. Punohet për identifikimin dhe kapjen e autorit/ëve të rastit;
-me datë 28.01.2026, në drejtim të rrugës "Vangjel Noti" automjeti me drejtues ende të paidentifikuar ka aksidentuar këmbësoren shtetasen M. Gj, 26 vjeçe, e cila ndodhet në spital, në kujdesin e mjekëve. Punohet për identifikimin e drejtuesit të automjetit dhe sqarimin e rrethanave të aksidentit.
-Më datë 29.01.2026, meth orës 04.30, në rrugën "Hasbi Deliu", në një pallat, pranë derës së banesës së shtetasit E. T., është konstatuar një bidon me lëndë të dyshuar djegëse (benzinë) dhe një sasi e kësaj lënde e pëhapur në tokë. Grupi hetimor vijon punën për zbardhjen e rrethanave të rastit.

Materialet procedurale iu referuan Prokurorisë së Tiranës, për veprime të mëtejshme.

Drejtoria Vendore e Policisë Fier

Specialistët për Hetimin e Narkotikëve të DVP Fier arrestuan shtetasin E. H., 24 vjeç, banues në Fier, pasi gjatë kontrollit në automjetin e tij, shërbimet e Policisë gjetën dhe sekuestruan një masë lënde të dyshuar narkotike kokainë.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Fier arrestuan shtetasin A. M., 43 vjeç, banues në fshatin Kreshpan, pasi për motive të dobëta, ka ushtruar dhunë ndaj xhaxhait të tij, shtetasit H. M., dhe djalit të tij, shtetasit A. M., si dhe i ka dëmtuar automjetin. Gjithashtu, për këtë rast, u procedua në gjendje të lirë shtetasja E. M., 37 vjeçe, pasi ka ndërhyrë në konflikt duke ushtruar dhunë ndaj kunatit të saj, shtetasit të arrestuar A. M., dhe babait të tij, shtetasit F. M., si dhe u shpall në kërkim shtetasi E. M., 22 vjeç (i aftë-ri ligjore), pasi gjatë konflikti, ka qëlluar në ajër, me armë gjahu të cilën e posedonte pa leje. Arma e gjahut u sekuestrua me cilësinë e provës materiale.

Gjithashtu, këta specialistë referuan materialet në Prokurori ku nisi procedimi penal për shtetasit:
-M. K., 39 vjeçe, banuese në Fier dhe L. G., 24 vjeçe, banuese në Elbasan, pasi janë konfliktuar me njëra-tjetrën;
-K. Dh., 40 vjeç, banues në Fier, pasi nuk i është bindur urdhrit të punonjësit të Policisë, për ndalimin e automjetit.

Specialistët për Hetimin e Krimeve Ekonomike të DVP Fier referuan materialet në Prokurori ku nisi procedimi penal për shtetasin J. K., 32 vjeç, banues në Fier, pasi ushtronte aktivitet ekonomik (vendparkim për automjete), pa kasë fiskale dhe pa e regjistruar në organet tatimore.

Në Komisariatin e Policisë Fier, shtetasja O. G., punonjëse në një farmaci në lagjen "Lin", kallëzon se një shtetas i paidentifikuar i ka vjedhur një shumë parash në farmaci. Po punohet për identifikimin dhe kapjen e tij.

Materialet procedurale iu referuan Prokurorisë së Fierit, për veprime të mëtejshme.

Drejtoria Vendore e Policisë Vlorë

Specialistët e Seksionit për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Sarandë arrestuan në flagrancë shtetasin E. P, 22 vjeç, pasi ka kallëzuar nëna e tij, se ai ka ushtruar dhunë psikologjike ndaj saj, ka dëmtuar derën e banesës, ka vjedhur sende në banesë dhe motorsipërin e babait të tij.

Gjithashtu, këta specialistë referuan materialet në Prokurori ku nisi procedimi penal për shtetasin M. Gj., 45 vjeç, banues në Sarandë, pasi ka kryer punime ndërtimi, pa leje.

Materialet procedurale iu referuan Prokurorisë, për veprime të mëtejshme.

Sarandë

Për motive të dobëta, dëmtuan me sende të forta dhe me mjet prerës, 2 shtetasa, arrestohen 2 shtetas dhe shpallet në kërkim 1.

2 të dëmtuarit janë jashtë rezikut për jetën.

Merjëherë pas njoftimit të marrë në orët e para të mëngjesit të sotëm, për një konflikt ndërmjet disa shtetasve, në lagjen "Baba Rexhep", Sarandë, shërbimet e Komisariatit të Policisë Sarandë organizuan punën dhe shkuan në vendngjarje, me qëllim zbardhjen e autorësisë dhe rrethanave të rastit.

Si rezultat i veprimeve të shpejta policore u arrestuan shtetasit M. H., 24 vjeç dhe Xh. S., 27 vjeç, si dhe u identifikua dhe u shpall në kërkim shtetasi F. Gj..

Nga veprimet hetimore dyshohet se shtetasit A. Gj., M. H. dhe Xh. S. kanë shkuar në banesën e shtetasit B. Q., ku për motive të dobëta, kanë goditur me sende të forta (shkopinj) dhe me mjet prerës, shtetasit E. Q., B. Q. dhe A. Q.. Si pasojë janë dëmtuar shtetasit E. Q dhe A. Gj., të cilët janë jashtë rrezikut për jetën.

Punohet për kapjen e shtetasit F. Gj., si dhe në drejtimin e Prokurorisë, punohet për të zbardhur dhe dokumentuar të gjitha rrethanat e këtij rasti.

Materialet procedurale iu referuan Prokurorisë, për veprime të mëtejshme, për veprën penale "Flagosja e rëndë me dasthje", kryer në bashkëpunim.

Drejtoria Vendore e Policisë Elbasan

Specialistët për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Financiare referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi penal për shtetasin M. H., 38 vjeç, banues në Elbasan. Në subjektin që ai administron, për grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve me përmbajtje metalike, gjatë kontrollit të ushtruar në bashkëpunim me Inspektoratin Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit, u konstatuan mbetje që nuk ishin trajtuar sipas legjislacionit në fuqi. Gjithashtu, për shkeljet e konstatuara nga grupi i inspektimit, subjekti u ndëshkua me masë administrative 2 000 000 lekë.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Elbasan referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi penal për shtetasit:
Xh. Q., 58 vjeç, pasi dyshohet se ka pushtuar tokën e një shtetasteje dhe e ka kanosur atë, me fjalë;

S. H., 54 vjeçe, pasi dyshohet se i ka vjedhur portofolin një 36-vjeçareje.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Cërrik referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi penal për shtetasin G. T., 55 vjeç, pasi dyshohet se ka pushtuar tokën e shtetasit B. T., 40 vjeç, në fshatin Marinës, si dhe ka kryer punime ndërtimi në këtë pronë, pa leje.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Cërrik referuan materialet në Prokurori dhe shpallën në kërkim shtetasin A. K., 27 vjeç, pasi në muajin maj 2025, i ka marrë me qira automjetin, shtetasit M. K., 44 vjeç, dhe nuk ia ka kthyer më. Po punohet për kapjen e 27-vjeçarit dhe për gjetjen e automjetit.

Më datë 28.01.2026, ka kallëzuar shtetasi A. L., se i kanë vjedhur bizhuteri në dyqanin e tij, në bulevardin "Qemal Stafa". Po punohet për zbardhjen e rrethanave të rastit, identifikimin dhe kapjen e autorit/ëve.

Materialet procedurale iu referuan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, për veprime të mëtejshme.

Drejtoria Vendore për Kufirin dhe Migracionin Vlorë

PKK Port Sarandë/Goditet një rast i mosdeklarimit të parave në kufi.

Tentoi të dilte nga Shqipëria, me 45 000 euro, pa i deklaruar, procedohet penalisht shtetasi grek.

Sekuestrohet shuma e parave.

Shërbimet e Policisë Kufitare në PKK Port Sarandë, gjatë kontrolleve të vazhdueshme që kryejnë me synim parandalimin, evidentimin dhe goditjen e paligjshmërive, i kanë gjetur një shtetasi, në cantë, 45 000 euro, të cilat ai po tentonte t'i nxirrte nga Shqipëria, pa i deklaruar.

Në vijim të veprimeve për rastin, u referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi penal për shtetasin grek

Kërko

Enter a word for search

Komisariati Dixhital

GET IT ON Google Play

Download on the App Store

Arkiva

Select Month

Linqe

- Arkiva
- Akademia e Sigurisë
- Ministria e Brendshme
- Agjencia e Mbikëqyrjes Policore
- Interpol
- Europol
- Misioni PAMECA V
- SCPA
- Projekti Trivalent